

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Ndertim Ujesjellesi per qytetin Repts, Bashkia Mirdite

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 9 (nente) muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231300-8 - Punime ndërtimi për tubacione uji dhe tubacione ujërash të zeza, 44162500-8 -
Tubacione të ujit të pijshëm

VLERA E FONDIT LIMIT: 73,197,757 (shtatedhjetë e tre mijë e njeqind e nentedhjetë e shtate mijë e shtateqind e pesedhjetë e shtate) lek pa tvsh.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga **Buxheti i Shtetit**.

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjdhjes së fituesit ka përgjdhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise ☐	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit ☐	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absoul (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 9 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 1 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Stafi / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në

seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

***Shënim:** Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënësi të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

***Shënim:** Për përmbushjen e kriterit të mësipërm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologji të ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikëqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh përbejnë sistemet e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të cilësive.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efëcente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:
Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë. projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij:

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikun e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksess të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në

kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të siellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Stafi/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me pervoiën e duhur mund të sielle rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilesi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventiv të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontrates, organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që ne me veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një veprë mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet të kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Për të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatoret ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migrues me miedisin të ricikluar/ eficient/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve

mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si nje iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 8 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (ndryshuar me Vendimin Nr. 545, datë 04.09.2024).

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar t'i zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM Nr. 285/2021 (i ndryshuar), kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur, e cila nuk përmend afatin e përcaktuar, do të vlerësohet minimalisht për një periudhë 2 (dy) vjeçare. Çdo ofertues, i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh, për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet me formulën e paraqitur në nënkriteret e mësipërme.

Autoriteti Kontraktor, në përcaktimin e sistemit të pikëzimit për vlerësimin e ofertave, ka mbajtur në konsideratë natyrën, kompleksitetin teknik, volumin e punimeve, rreziqet e zbatimit dhe rëndësinë e secilit element në realizimin me sukses të objektit të kontratës.

Sistemi i pikëzimit është ndërtuar mbi një balancë ndërmjet elementit ekonomik dhe elementeve teknike e cilësore, duke respektuar parimet e përcaktuara në nenin 3 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe dispozitat e nenit 87 të Ligjit nr. 162/2020 për përdorimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme dhe kërkesat e nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar për argumentimin e kriterëve.

*Sistemi i propozuar i vlerësimit me **100 pikë**, ku **50% e peshës i jepet çmimit dhe 50% elementëve cilësorë**, është i përshtatshëm për kontratat e zbatimit të punimeve civile dhe infrastrukturore, pasi siguron përzgjedhjen e ofertës me **vlerën më të mirë për paratë publike (Best Price-Quality Ratio)** dhe jo thjesht ofertën me çmimin më të ulët. Ky parim përdoret gjerësisht në prokurimet publike europiane për punime komplekse, ku cilësia e organizimit, stafi, afati i realizimit dhe ndikimi mjedisor ndikojnë drejtpërdrejt në suksesin e kontratës.*

Pesha 50% e çmimit garanton ruajtjen e konkurrencës ekonomike dhe përdorimin me eficiencë të fondeve publike. Formula relative favorizon ofertën më ekonomike, por pa lejuar që kontrata të fitohet vetëm nga çmimi më i ulët në dëm të cilësisë së zbatimit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në punimet e ujësjellësit, ku ofertat me çmime shumë të ulëta mund të sjellin vonesa, mungesë burimesh ose probleme cilësore gjatë ekzekutimit.

“Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit” (20 pikë)

Ky kriter vlerëson kapacitetin real të operatorit për të organizuar punimet dhe për të përfunduar kontratën brenda afatit. Në projekte ujësjellësi, ku ekzistojnë procese të shumta si gërmimet, vendosja e tubacioneve, ndërtimi i veprave civile dhe instalimi i pajisjeve, organizimi i mirë i punimeve ndikon drejtpërdrejt në:

- reduktimin e vonesave;
- minimizimin e kostove shtesë;
- kufizimin e ndërprerjeve për komunitetin;
- përfundimin më të shpejtë të investimit.

Vlerësimi i mobilizimit, grafikut të detajuar dhe metodologjive inovative nxit operatorët të paraqesin zgjidhje më efikase dhe më produktive. Afati i realizimit konsiderohet ndër kriteret kryesore të ofertës ekonomikisht më të favorshme në kontratat e punimeve.

“Stafi / Organizimi i kompanisë” (15 pikë)

Punimet e infrastrukturës varen në masë të madhe nga kualifikimi dhe eksperiencia e stafit teknik. Për këtë arsye, sistemi i pikëzimit vlerëson:

- formimin akademik;
- eksperiencën profesionale;
- eksperiencën në projekte të ngjashme;
- organizimin e strukturës së menaxhimit.

Ky kriter redukton riskun e dështimit të kontratës, pasi favorizon operatorët që disponojnë staf të specializuar dhe eksperiencë konkrete në projekte të ngjashme. Legjislacioni dhe praktika europiane e konsiderojnë organizimin dhe eksperiencën e stafit si element që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e ekzekutimit të kontratës.

“Ndikimi në mjedis dhe ndikimi social” (10 pikë)

Projektet e ujësjellësit përfshijnë gjermime, transport materialesh dhe ndërhyrje në mjedis. Përfshirja e këtij kriteri:

- nxit përdorimin e materialeve dhe pajisjeve më miqësore me mjedisin;
- redukton ndikimet negative gjatë ndërtimit;
- promovon punësimin lokal dhe përfitimet sociale për komunitetin;
- harmonizon projektin me objektivat moderne të zhvillimit të qëndrueshëm.

Kriteret mjedisore dhe sociale konsiderohen tashmë pjesë integrale e konceptit të ofertës ekonomikisht më të favorshme në prokurimet publike moderne.

“Periudha e garancisë” (5 pikë)

Garancia e zgjatur tregon besimin e operatorit në cilësinë e punimeve dhe materialeve të përdorura. Përfitimet kryesore janë:

- ulja e kostove të mirëmbajtjes për Autoritetin Kontraktor;
- siguria për funksionimin afatgjatë të investimit;
- përgjegjësi më e lartë e kontraktorit për cilësinë e zbatimit.

Megjithëse ka peshë më të ulët (5%), ky kriter ndihmon në diferencimin e operatorëve që ofrojnë standarde më të larta cilësie.

Ky sistem pikëzimi është i rëndësishëm krijon një ekuilibër ndërmjet **eficiencës ekonomike (50 pikë)** dhe **cilësisë së realizimit (50 pikë)**. Për një projekt zbatimi ujësjellësi, suksesi i investimit nuk varet vetëm nga çmimi, por edhe nga organizimi i punimeve, kapaciteti teknik i stafit, menaxhimi mjedisor dhe garancia e objektit. Ky model vlerësimi minimizon riskun e ofertave anormalisht të ulëta, rrit cilësinë e ekzekutimit dhe siguron përdorimin më efektiv të fondeve publike, duke identifikuar ofertën që paraqet raportin më të mirë ndërmjet çmimit dhe cilësisë.

Autoriteti Kontraktor ndalon mbështetjen në kapacitet e subjekteve të tjera si më poshtë:

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

- Kapaciteti ekonomik dhe financiar Kriteria të veçanta të kualifikimit, Pika 2.2.1, 2.2.2,
- Përvoja e suksesshme në kontrata të mëparshme, kërkuar sipas pikës 2.3.1 të Kapacitetit teknik të Kriteria të veçanta të Kualifikimit ;
- Licenca e kërkuara sipas pikës 2.3.2/a, 2.3.2 b), 2.3.2 c) , të kapacitetit Teknik të Kriteria të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 7 e DST-së.
- Stafi Teknik i kërkuar sipas pikës 2.3.3/a, 2.3.3/b, 2.3.3 c), 2.3.3/d, 2.3.4 të Kapacitetit Teknik të Kriteria të veçanta të Kualifikimit, Shtojca 7 e DST-se.

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenit 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); Nenit 90, pikat 5 dhe 6 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar).

Autoriteti kontraktor ka vlerësuar se kapacitetet teknike dhe profesionale që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e punimeve kryesore nuk mund të transferohen tërësisht tek subjekte të treta, pasi kjo do të cenonte qëllimin e verifikimit të aftësisë reale të operatorit ekonomik që paraqet ofertën.

Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera është lejuar vetëm në masën që këto subjekte të marrin përsipër realisht realizimin e pjesës përkatëse të punimeve dhe të disponojnë licencat, personelin, pajisjet dhe eksperiencën që lidhet me zërat konkretë të preventivit që do të ekzekutojnë. Për këtë arsye është kërkuar që secili subjekt mbështetës ose anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë të disponojë licencat përkatëse në raport me punimet që merr përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit dhe ndarjes së punimeve.

Ky kufizim mbështetjet në faktin se:

- Licencat e ndërtimit përbëjnë autorizime profesionale të lidhura me aftësinë konkrete të subjektit për të realizuar kategori të caktuara punimesh dhe nuk mund të përdoren formalisht nga një operator që nuk disponon kapacitetet minimale për ekzekutimin e kontratës.
- Drejtuesit teknikë, stafi inxhinierik dhe specialistët e kërkuar janë të lidhur drejtpërdrejt me realizimin e punimeve të objektit dhe me mbikëqyrjen teknike të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit. - Pajisjet dhe materialet teknologjike të kërkuara në projekt kërkojnë njohuri të specializuara instalimi dhe përgjegjësi profesionale që nuk mund të garantohen nëse operatori ofertues nuk disponon vetë kapacitetet bazë teknike për realizimin e kontratës.

Për rrjedhojë, kufizimi i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera është vendosur për të garantuar që operatorit ekonomik ofertues të zotërojë vetë kapacitetet kryesore dhe thelbësore për realizimin e kontratës, ndërsa mbështetja nga subjektet e tjera të shërbejë vetëm si kapacitet plotësues dhe jo si zëvendësim i plotë i aftësisë teknike dhe profesionale të operatorit ofertues.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Per Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizimeve, Lezhe Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë sipas nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar **të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

***** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatave të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare; ...3.** Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili përcakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe

çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 datë 10.05.2018 "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 9 ku parashikohet: "Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përfundimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat"; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar" (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në keto kushte, vleresojmë të kërkojmë kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi lëshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion përfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore

të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”*

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime**

të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM te dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkitimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

Kategoria NP - 1 Punime germimi në toke	Klasifikimi B
Kategoria NP - 4 Rrugë autostrada, mbikalime etj.	Klasifikimi A
Kategoria NP - 7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Klasifikimi B
Kategoria NP – 11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.	Klasifikimi A
Kategoria NP - 12 Punime të inxhinjerise se mjedisit	Klasifikimi A
Kategoria NS -4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to etj.,	Klasifikimi A
Kategoria NS – 9 Punime strukturore speciale	Klasifikimi A
Kategoria NS – 18 Punime topogjeodezike	Klasifikimi A

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t’i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Duke qenë se objekti është ndërtim i sistemit të ujësjellësit me vepër marrjeje, linjë transmetimi, rrjet shpërndarës, punime elektrike dhe rikthime të sipërfaqeve, kategoritë e kërkuara justifikohen si më poshtë:

Kategoria NP-1 – Punime gjurmimi në tokë (Klasifikimi B)- Kjo kategori është e domosdoshme pasi pjesa më e madhe e vëllimit të punimeve lidhet me hapjen e kanaleve për vendosjen e tubacioneve të ujësjellësit, gjurmime për veprat civile, pusetat, dhomat teknologjike dhe strukturat ndihmëse.

Në preventiv përfshihen zëra si: Gjurmime dheu për linjën e transmetimit; Gjurmime për rrjetin shpërndarës; Gjurmime për puseta dhe vepra betoni; Ngarkim, transport dhe sistemim i materialit të gjermuar; Mbushje dhe ngjeshje e kanaleve. Vëllimi i konsiderueshëm i gjurmimeve përgjatë gjithë gjatësisë së rrjetit justifikon kërkesën për klasifikimin B.

Kategoria NP-4 – Rrugë, autostrada, mbikalime etj. (Klasifikimi A)- Punimet e ujësjellësit zhvillohen kryesisht përgjatë rrugëve ekzistuese dhe kërkojnë ndërhyrje në trupin e rrugës. Preventivi përfshin: Prerje të shtresave asfaltike; Hapje kanalesh në rrugë; Rikonstruksion dhe rivendosje të shtresave rrugore; Shtresa stabilizanti dhe bazamente; Asfaltime dhe rikthim në gjendjen fillestare të rrugëve.

Kategoria NP-7 – Ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje (Klasifikimi B)- Kjo është kategoria kryesore e objektit. Punimet kryesore të preventivit lidhen me: Furnizimin dhe montimin e tubacioneve PEHD; Ndërtimin e linjës së transmetimit; Ndërtimin e rrjetit shpërndarës; Montimin e rakorderive, valvolave dhe aksesoreve; Ndërtimin e pusetave; Testimin dhe dezinfektimin e rrjetit; Instalimin e matësve dhe pajisjeve hidraulike.

Për shkak se pjesa kryesore e vlerës së kontratës përbëhet nga punime ujësjellësi, është hartuar kërkesa për këtë kategori

Kategoria NP-11 – Nënstacione, kabina transformatori, linja TM/TU dhe shpërndarje energjie (Klasifikimi A) Në preventiv parashikohen instalime elektrike dhe furnizim me energji të pajisjeve të sistemit.

Kjo kategori justifikohet nga zëra si: Furnizimi me energji i objekteve teknologjike; Kabllime elektrike; Panele komandimi; Sisteme monitorimi dhe automatizimi; Pajisje kontrolli dhe telekomandimi (SCADA). Këto elemente kërkojnë operatorë me eksperiencë në instalime elektrike dhe sisteme energjetike.

Kategoria NP-12 – Punime të inxhinierisë së mjedisit (Klasifikimi A)- Objekti ka ndikim të drejtpërdrejtë në mjedis gjatë fazës së ndërtimit. Kjo kategori lidhet me: Menaxhimin e materialeve të gërmimit; Mbrojtjen e burimeve ujore;

Rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura; Kontrollin e erozionit; Sistemimin e ujërave sipërfaqësore; Masat për minimizimin e ndikimit mjedisor gjatë punimeve. Punimet janë të lidhura ngushtë me mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e ndikimeve të projektit.

Kategoria NS-4 – Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to (Klasifikimi A)- Në preventiv përfshihen punime civile ndihmëse si: Suvatime; Rifinitura të pusetave; Riparime murature; Rikthime të elementeve ekzistuese të dëmtuara gjatë punimeve; Punime të vogla arkitektonike në objektet teknologjike.

Kategoria NS-9 – Punime strukturore speciale (Klasifikimi A)

Kjo kategori argumentohet nga prania në preventiv e: Veprave të betonarmeve; Dhomave teknologjike; Pusetave speciale; Strukturave mbajtëse të pajisjeve; Blloqeve të ankorimit të tubacioneve; Strukturave hidroteknike të veprës së marrjes. Këto elemente kërkojnë njohuri specifike në punime strukturore dhe betonarme.

Kategoria NS-18 – Punime topogjeodezike (Klasifikimi A)- Objekti shtrihet në një gjatësi të konsiderueshme dhe kërkon: Piketime të traseve; Rilevime topografike; Hedhje koordinatash; Kontroll altimetrik dhe planimetrik; Përgatitjen e dokumentacionit “as built”.

Punimet topografike janë të domosdoshme gjatë gjithë ciklit të realizimit të rrjetit të ujësjellësit, nga piketimi fillestar deri në kolaudim.

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise vlefshme, Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise vlefshme, Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE**
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015/ ose 14001:2026 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit), e vlefshme, Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE**
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 45001-2018 ose 45001:2023 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), ose cetifikaten ekuivalente, e vlefshme, Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga te gjithë anetaret e BOE**
- Certifikatë **SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021**, (Sistemi i Menaxhimit të Cilesise ne Saldim), e vlefshme, ose ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të vlefshme të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj (përveçse gjuhes angleze), ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë- Kërkesa për certifikatën ISO 9001:2015 është e nevojshme për shkak të kompleksitetit të proceseve që përfshin kontrata dhe nevojës për kontroll të cilësisë në të gjitha fazat e zbatimit.

Në preventiv parashikohen punime si: Furnizim dhe montim i tubacioneve PEHD të rrjetit të ujësjellësit; Furnizim dhe montim i rakorderive, valvolave dhe aksesoreve; Ndërtim pusetash dhe strukturash betoni; Testime hidraulike dhe vënie në punë e rrjetit; Furnizim dhe instalim i matësve dhe pajisjeve të kontrollit.

Këto procese kërkojnë procedura të standardizuara për:kontrollin e materialeve hyrëse; gjurmueshmërinë e produkteve; kontrollin e punimeve gjatë zbatimit; verifikimin dhe testimin përfundimtar. Prandaj ISO 9001 garanton që operatori ekonomik disponon një sistem të certifikuar për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë së punimeve dhe materialeve të përdorura në objekt.

ISO 14001:2015 ose 14001:2026 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

Kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me ndikimin mjedisor të punimeve të parashikuara në preventiv.

Objekti përfshin:Gërmime lineare përgjatë trasesë së ujësjellësit; Transport dhe depozitim materialesh; Punime në zona të banuara; Ndërhyrje në rrugë dhe sipërfaqe ekzistuese; Menaxhim të mbetjeve të ndërtimit; Rikthim të sipërfaqeve në gjendjen fillestare.

Gjatë realizimit ekzistojnë rreziqe si:ndotja e tokës dhe ujërave; pluhurat dhe emetimet; menaxhimi i materialeve të gërmuara; ndikimi në mjedisin përreth.

ISO 14001 vërteton se operatori ekonomik disponon procedura të certifikuara për identifikimin, monitorimin dhe minimizimin e ndikimeve mjedisore gjatë realizimit të kontratës.

ISO 45001:2018 ose 45001:2023 – Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë

Punimet e parashikuara në preventiv përfshijnë aktivitete me risk të lartë për sigurinë e punonjësve, si:Gërmime të thella për vendosjen e tubacioneve; Punime me makineri të rënda (eskavatorë, fadroma, kamionë); Punime betonarme; Montim tubacionesh dhe rakorderish; Punime elektrike dhe instalime teknologjike; Testime nën presion të rrjetit.

Për shkak të këtyre proceseve ekziston risk për:shembje të kanaleve; aksidente me makineri; dëmtime gjatë ngritjes së ngarkesave; rreziqe elektrike; incidente gjatë testimeve hidraulike.

ISO 45001 garanton se operatori ekonomik disponon procedura të organizuara për menaxhimin e sigurisë në kantier dhe mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë realizimit të kontratës.

SSH/DIN/EN/UNI ISO 3834-2:2021 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim

Kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që përfshijnë:Furnizim dhe montim të tubave të çelikut; Rakorderi metalike; Elementë metalikë të veprës së marrjes; Lidhje dhe bashkime metalike; Punime speciale të montimit të tubacioneve; Struktura metalike ndihmëse.

Në sistemet e ujësjellësit, cilësia e saldimit është element kritik për:rezistencën mekanike; hermeticitetin e rrjetit; jetëgjatësinë e instalimit; sigurinë e funksionimit.

Defektet në saldim mund të shkaktojnë:rrjedhje uji; dëmtime strukturore; ndërprerje të furnizimit; kosto shtesë riparimi.

Për këtë arsye ISO 3834-2 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon procedura të kontrolluara dhe personel të kualifikuar për realizimin e proceseve të saldimit sipas standardeve ndërkombëtare.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventivin e punimeve, për listen e artikujve, si me poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE**
- ✓ **Tuba Çeliku**
- ✓ **Rakorderi për ujësjiellës dhe polietileni EF**
- ✓ **Saracineska**
- ✓ **Matës uji**
- ✓ **Sistemi Klorinimit**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj (përveçse gjuhës angleze), ky dokument mund të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. **Shënim:** Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.
- **Shënim:** Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.
- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar

nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi ose marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe katalogëve teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre

dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.** 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Kjo kërkesë është në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", pasi lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, natyrën e punimeve, peshën ekonomike të materialeve në preventiv dhe rëndësinë e tyre për funksionimin e sistemit të ujësjellësit.

Nga analiza e preventivit rezulton se pjesa më e madhe e vlerës së kontratës lidhet me furnizimin dhe instalimin e materialeve hidraulike dhe elektromekanike, të cilat përbëjnë komponentët kryesorë të rrjetit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë e investimit.

1. Tuba Ujësjellësi PE

Kërkesa për autorizim prodhuesi, katalog teknik dhe certifikime ISO justifikohet nga fakti se tubacionet PE përbëjnë zërin kryesor të furnizimit në preventiv dhe realizojnë funksionin bazë të transmetimit dhe shpërndarjes së ujit.

Në preventiv janë parashikuar: Furnizimi i tubave PE me diametra të ndryshëm; Montimi i tubacioneve përgjatë gjithë rrjetit; Testimi dhe vënia në punë e linjave.

Për shkak të: volumit shumë të madh të tubacioneve; peshës së konsiderueshme ekonomike në kontratë; ndikimit direkt në funksionimin e sistemit;

Autoriteti Kontraktor duhet të sigurohet që produktet ofrohen nga prodhues të autorizuar dhe përmbushin standartet teknike të projektit.

Autorizimi garanton: origjinën e produktit; kapacitetin e furnizimit; mbështetjen teknike; garancinë e produktit.

2. Tuba Çeliku

Në preventiv parashikohen segmente të rrjetit dhe elementë specialë ku kërkohet përdorimi i tubave të çelikut për shkak të kushteve të ngarkesës mekanike dhe presionit.

Këta zëra kanë rëndësi të veçantë sepse: punojnë në kushte të vështira teknike; kërkojnë kontroll të cilësisë së materialit bazë; lidhen me procese saldimi dhe testimi.

Defektet në këto materiale mund të sjellin:ndërprerje të furnizimit; rrjedhje të konsiderueshme;dëmtime të infrastrukturës.

Për këtë arsye kërkohet lidhje direkte me prodhuesin dhe dokumentacion teknik i certifikuar.

3. Rakorderi për ujësjellës dhe polietileni EF

Preventivi përmban një numër të konsiderueshëm rakorderish dhe elementësh elektrofuzion (EF), të cilët sigurojnë lidhjen dhe funksionimin e rrjetit.

Këta artikuj përfshijnë:bashkues; bërryla; reduksione; T; flanaxha; elementë elektrofuzioni.

Edhe pse individualisht kanë vlerë më të ulët se tubacionet, në total përbëjnë një volum të konsiderueshëm ekonomik dhe teknik.

Mosrespektimi i standardeve të prodhimit mund të shkaktojë:rrjedhje; humbje uji; avari të sistemit.

Prandaj kërkohet katalog teknik dhe autorizim prodhuesi për të garantuar përputhshmërinë me specifikimet e projektit.

4. Saracineskat

Saracineskat janë ndër pajisjet më të rëndësishme operacionale të rrjetit.

Në preventiv parashikohen:saracineska izolimi; saracineska sektorizimi; pajisje kontrolli të rrjetit.

Ato përdoren për:ndërhyrje mirëmbajtjeje; menaxhim të avarive; kontroll të rrjedhës së ujit.

Duke qenë se përfaqësojnë pajisje me vlerë të konsiderueshme ekonomike dhe ndikim të drejtpërdrejtë në operimin e rrjetit, është e nevojshme që origjina dhe parametrat teknikë të verifikohen përmes autorizimit dhe katalogëve të prodhuesit.

5. Matësat e ujit

Matësat e ujit përbëjnë pajisje matëse ligjore dhe ndikojnë drejtpërdrejt në:matjen e konsumit; faturimin; reduktimin e humbjeve administrative; menaxhimin e ujit të pijshëm.

Për këtë arsye kërkesat për:OIML R49janë të nevojshme pasi ky standard përcakton:klasat e saktësisë; performancën metrologjike; kushtet e testimit të matësve.

Kërkesa garanton që matësat e ofertuar përmbushin standardet ndërkombëtare të matjes.

MID -Certifikimi MID kërkohet pasi matësat janë instrumente matëse që përdoren për qëllime tregtare dhe faturimi.

Kjo certifikatë garanton:saktësinë e matjes; pranueshmërinë ligjore të pajisjes; përputhshmërinë me legjislacionin european dhe shqiptar.

Për shkak se matësat përbëjnë një komponent me ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat e operatorit të ujësjellësit, kërkesa konsiderohet plotësisht proporcionale.

6. Sistemi i Klorinimit

Sistemi i klorinimit është komponent kritik për garantimin e cilësisë së ujit të pijshëm.

Në preventiv parashikohet:furnizimi i pajisjeve të klorinimit; montimi; integrimi me sistemin ekzistues; testimi dhe vënia në funksion.

Kjo pajisje lidhet drejtpërdrejt me:sigurinë sanitare; mbrojtjen e shëndetit publik; përmbushjen e standardeve të ujit të pijshëm.

Për shkak të rëndësisë së lartë funksionale dhe ekonomike të këtij sistemi, kërkohet dokumentacion i plotë teknik dhe autorizim nga prodhuesi.

Materialet dhe pajisjet e mësipërme përfaqësojnë pjesën më të madhe të vlerës së furnizimeve të kontratës dhe janë komponentë afatgjatë të investimit.

Prandaj kërkohet që prodhuesit të disponojnë:

- **ISO 9001:2015**, për të garantuar kontrollin e proceseve të prodhimit, gjurmueshmërinë dhe cilësinë e produkteve;
- **ISO 14001:2015/ 14001:2026** për të garantuar se produktet prodhohen në përputhje me standardet e menaxhimit mjedisor.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën **50 (pesedhjetë)** punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
 - Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet forms elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se **50 (pesedhjetë)** punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

Në përputhje me nenin 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikues disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se 80 punonjësish për periudhën e 3 muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave.

Ky kriter është vendosur duke u bazuar në natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve, si dhe në normativat e fuqisë punëtore të përcaktuara në Manualin të Ndërtimit, i cili përbën bazën e hartimit të preventivit dhe analizave teknike të objektit.

*Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë një numër mesatar prej të paktën **50 punonjësish**, përfshirë stafin teknik, është në përputhje me natyrën, kompleksitetin, shtrirjen gjeografike dhe*

volumet e punimeve të parashikuara në preventiv dhe nuk tejkalon nevojat reale për realizimin e kontratës.

Objekti i prokurimit nuk përfshin vetëm furnizimin me materiale, por kryesisht realizimin e punimeve civile, hidraulike, mekanike, elektrike dhe topografike për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit. Punimet do të zhvillohen njëkohësisht në disa fronte pune dhe kërkojnë angazhimin paralel të ekipeve të specializuara.

Preventivi përfshin: gërmime për kanalet e tubacioneve; transport dhe depozitim materiale; mbushje dhe ngjeshje të kanaleve; furnizim dhe montim të tubave PE; furnizim dhe montim të tubave të çelikut; montim rakorderish dhe pajisjesh hidraulike.

Për realizimin e këtyre proceseve nevojiten njëkohësisht: eskavatoristë; automakinistë; montatorë tubacionesh; saldatorë; hidraulikë; punëtorë ndihmës.

Vetëm për zhvillimin paralel të 2–3 fronteve të punës kërkojnë disa ekipe operative me mbi 20–25 punonjës në terren.

Punimet civile dhe strukturat betonarme- Preventivi përfshin: puseta; blloqe ankorimi; vepra marrjeje; struktura betoni dhe betonarme; rikthime të sipërfaqeve. Për këto procese kërkojnë: muratorë; karpentierë; hekurkthyes; betonues; teknikë ndërtimi. Punimet civile realizohen paralelisht me shtrimin e rrjetit dhe kërkojnë ekipe të dedikuara.

Punimet elektromekanike dhe të automatizimit- Në preventiv janë parashikuar: sisteme klorinimi; pajisje kontrolli; matës uji; pajisje hidraulike; instalime elektrike; sisteme monitorimi. Këto procese kërkojnë: inxhinier elektrik; elektrikistë;

Punimet topografike dhe kontrolli Teknik- Për shkak të gjatësisë së konsiderueshme të rrjetit dhe shtrirjes në disa zona, kërkojnë: topografë; teknikë topografë; inxhinierë gjeodetë; personel për dokumentacionin. Këto shërbime duhet të jenë të disponueshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Organizimi i kontratës brenda afatit të realizimit- Sipas dokumenteve të tenderit, operatorët ekonomikë do të vlerësohen edhe mbi bazën e: grafikut të punimeve; kohës së mobilizimit; organizimit të stafit.

Për të realizuar objektin brenda afatit të kontratës, operatori duhet të ketë kapacitet për: zhvillimin e disa proceseve në të njëjtën kohë; punë në disa segmente të rrjetit paralelisht; zëvendësimin e menjëhershëm të personelit në rast nevojë. Një operator me staf shumë më të ulët do të kishte vështirësi objektive në përmbushjen e volumeve të preventivit brenda afateve të kërkuara.

Duke marrë në konsideratë: vlerën e konsiderueshme të investimit; volumnin e punimeve lineare të rrjetit; numrin e madh të zërave të preventivit; nevojën për ekipe të specializuara në gërmim, montim, betonarme, saldim, instalime elektrike dhe topografi; një kapacitet minimal prej 50 punonjësish konsiderohet proporcional dhe i nevojshëm për realizimin e kontratës.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|--|---------|
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (nje) |
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeodet / Topograf / Markshajder | 1 (një) |

- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtnesit teknik të jenë të siguruar sipas legjislacionit në fuqi). Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika b, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedurë të shpallura fituese.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtnes teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi Profili Infrastruktura e transportit 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe të figurojë në Listepagesa për të paktën 3 muajt e Fundit.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të përcaktojë me anë të një **deklaratë** (nga Administratori i Shoqërisë) **Drejtnesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperience) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Shënim: Ky kriter konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtnesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

e) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si dhe të përfshirë në listepagesa për periudhën 3 muajt e fundit, me profesionet si më poshtë:

- 2 (dy) Teknik Ndertimi
- 1 (nje) Teknik Topograf
- 3 (tre) hidraulike
- 2 (dy) Specialist për montim tubash
- 1 (nje) murator
- 3 (tre) betonues
- 1 (nje) suvatures
- 2 (dy) karpentier
- 2 (dy) hekurkthyes
- 2 (dy) punëtore për punime në rrugë dhe asfaltim
- 3 (tre) shoferë për drejtim mjeteve të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, leshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (me përjashtim të punonjësve shoferë) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të leshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

***** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

e) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të pakten:

- 2 (dy) manovrator Eskavatoristë
- 2 (dy) manovrator Automakinistë
- 1 (nje) manovrator Buldozeristë

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontrate pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; si dhe të figurojnë në listepagesat e operatorit ekonomik ofertues për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë emër/mbiëmër, profilin e punës, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, si dhe numrin dhe afatin e vlefshmerisë së dëshmisë së aftësisë profesionale.

Në rastin kur punonjësit Automakinist, Eskavatoristë ose Buldozerist janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohet të figurojnë në listepagesat e shoqërisë).

***** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; **dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Gjithashtu, bazuar në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore për licencimin profesional në fushën e ndërtimit, zbatimi i punimeve të ndërtimit duhet të realizohet nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e personelit teknik të kualifikuar sipas profileve përkatëse të inxhinierisë.

Kërkesa për disponimin e personelit inxhinierik kryesor dhe mbështetës është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin teknik, volumet e punimeve dhe disiplinat inxhinierike të përfshira në preventivin e objektit. Projekti nuk përbëhet vetëm nga furnizimi dhe montimi i tubacioneve, por përfshin një kombinim punimesh hidroteknike, civile, infrastrukturore, topografike, mekanike dhe elektrike, të cilat kërkojnë mbikëqyrje dhe drejtim teknik nga specialistë të kualifikuar.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Hidroteknik në cilësinë e Drejtuesit Teknik**, të përfshirë në licencën e shoqërisë, është plotësisht e lidhur me natyrën e objektit të prokurimit, i cili konsiston në ndërtimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe ka si komponent kryesor punimet hidroteknike dhe hidraulike.

Nga analiza e preventivit rezulton se pjesa dominuese e punimeve dhe e vlerës ekonomike të kontratës lidhet me: furnizimin dhe montimin e tubacioneve PE të rrjetit të ujësjellësit; furnizimin dhe montimin e tubave të çelikut; montimin e rakorderive dhe elementëve të lidhjes; montimin e

saracineskave dhe pajisjeve të kontrollit të rrjetit; montimin e matësve të ujit; ndërtimin e pusetave hidraulike; instalimin e sistemit të klorinimit; testimet hidraulike të rrjetit; dezinfektimin dhe vënien në funksion të sistemit.

Këto zëra përfaqësojnë komponentët kryesorë funksionalë të investimit dhe kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme nga një specialist i fushës së hidroteknikës.

Inxhinieri Hidroteknik është figura profesionale përgjegjëse për:interpretimin dhe zbatimin e projektit hidraulik; kontrollin e kuotave dhe pjerrësive të linjave të ujësjellësit; verifikimin e diametrave dhe klasave të presionit të tubacioneve; kontrollin e montimit të rakorderive dhe pajisjeve hidraulike; mbikëqyrjen e provave hidraulike dhe testeve nën presion; verifikimin e parametrave të funksionimit të rrjetit; koordinimin e proceseve të klorinimit dhe vënies në punë të sistemit.

Gjithashtu, duke qenë se projekti përfshin një rrjet ujësjellësi me gjatësi të konsiderueshme, me disa nje teknologjike dhe pajisje kontrolli, drejtimi teknik i punimeve nuk mund të realizohet nga profile të tjera inxhinierike, pasi vetëm Inxhinieri Hidroteknik disponon formimin profesional të nevojshëm për të garantuar zbatimin korrekt të parametrave hidraulikë të projektit.

Kërkesa është gjithashtu proporcionale me volumet e preventivit, pasi pjesa më e madhe e punimeve lidhet drejtpërdrejt me:rrjetin e transmetimit të ujit; rrjetin e shpërndarjes; pajisjet hidraulike të kontrollit; elementët e sigurisë dhe funksionimit të sistemit.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Ndërtimi në cilësinë e Drejtuesit Teknik**, të përfshirë në licencën e shoqërisë, është e domosdoshme dhe plotësisht proporcionale me natyrën dhe volumet e punimeve civile të parashikuara në preventiv.

Megjithëse objekti kryesor i kontratës lidhet me ndërtimin e sistemit të ujësjellësit, realizimi i tij shoqërohet me një volum të konsiderueshëm punimesh ndërtimore dhe infrastrukturore, të cilat kërkojnë drejtim dhe mbikëqyrje nga një inxhinier i profilit të ndërtimit.

Nga preventivi rezulton se përfshihen zëra të tillë si:gërmime në tokë për hapjen e kanaleve të tubacioneve; gërmime për puseta dhe struktura teknologjike; mbushje dhe ngjeshje e kanaleve;shtresa stabilizuese dhe rikonstruksion i terrenit; ndërtim pusetash betoni dhe betonarme; blloqe ankorimi (anchor blocks) për tubacionet; punime betoni dhe betonarme për veprat ndihmëse; rikthim i sipërfaqeve të dëmtuara gjatë punimeve; punime murature dhe rifiniture; ndërhyrje në rrugë dhe rehabilitim i shtresave rrugore.

Këto procese përbëjnë një pjesë të rëndësishme të volumeve fizike të kontratës dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm teknik për:zbatimin e projektit konstruktiv; kontrollin e cilësisë së betonit dhe materialeve të ndërtimit; kontrollin e gërmimeve dhe mbushjeve; verifikimin e parametrave të ngjeshjes; respektimin e specifikimeve teknike të punimeve civile; organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve në kantier.

Për më tepër, gjatë realizimit të rrjetit të ujësjellësit, punimet hidraulike dhe ato civile zhvillohen paralelisht. Çdo segment i tubacionit shoqërohet me gërmime, mbushje, betonime, puseta dhe rikthime të sipërfaqeve, çka e bën të domosdoshëm praninë e një Inxhinieri Ndërtimi për të garantuar realizimin korrekt të këtyre proceseve.

Duke marrë në konsideratë:volumin e konsiderueshëm të gërmimeve dhe mbushjeve; numrin e strukturave civile të parashikuara në preventiv; punimet e betonit dhe betonarmesë; ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese; nevojën për koordinim të vazhdueshëm të proceseve ndërtimore;

Kërkesa për angazhimin e **1 (një) Inxhinieri Gjeodet / Topograf / Markshajder** si drejtues teknik është e nevojshme dhe e justifikuar nga natyra, shtrirja dhe volumi i punimeve të parashikuara në preventiv.

Punimet e parashikuara përfshijnë ndërhyrje në rrjete ujësjellësi dhe vepra të infrastrukturës hidroteknike, punime rrugore, gërmime, vendosje tubacionesh, ndërtim dhe rikonstruksion të elementeve infrastrukture, të cilat kërkojnë kontroll të vazhdueshëm topografik gjatë zbatimit. Për realizimin korrekt të këtyre zërave është i domosdoshëm përcaktimi i saktë i akseve, kuotave, koordinatave, pjerrësive dhe pozicionit planimetrik e altimetrik të veprave.

Inxhinieri Gjeodet/Topograf është përgjegjës për piketimin e veprave dhe linjave të punës, përcaktimin e akseve të tubacioneve dhe elementeve të rrjetit, kontrollin e kuotave të gërmimeve dhe mbushjeve, verifikimin e pjerrësive të tubacioneve, matjet para dhe pas realizimit të punimeve, si dhe për kontrollin e përputhjes së punimeve të kryera me projektin dhe dokumentacionin teknik. Veçanërisht, për zërat e preventivit që lidhen me gërmimet, shtrimin dhe montimin e tubacioneve, ndërtimin e pusetave dhe veprave të tjera hidroteknike, si dhe punimet rrugore dhe rikonstruksionet, saktësia topografike është kusht për garantimin e funksionalitetit të veprës dhe respektimin e parametrave teknikë të projektit.

Gjithashtu, duke pasur parasysh shtrirjen e punimeve në disa segmente dhe volumin e punimeve të parashikuara, prania e një inxhinieri gjeodet/topograf si drejtues teknik siguron kontrollin sistematik të progresit, dokumentimin e volumeve të realizuara dhe përgatitjen/verifikimin e matjeve topografike që shërbejnë si bazë për situacionet e punimeve.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Elektrik** është vendosur në përputhje me natyrën, volumin dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit **“Ndërtim Ujësjellësi për qytetin Reps”**, pasi në realizimin e veprës parashikohen punime të mirëfillta elektrike, të cilat kërkojnë drejtim dhe kontroll teknik nga personel i kualifikuar i profilit elektrik. Konkretisht, në preventiv parashikohet kapitulli **“Instalime për ndriçim”**, ku përfshihen ndër të tjera: çelësa dhe priza, priza shuko universale, panele metalike, tuba instalimi, elektroda tokëzimi dhe elementë të tjerë të instalimit elektrik. Gjithashtu parashikohen punime për linjat e furnizimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë kablo dhe përcjellës elektrikë të seksioneve të ndryshme.

Preventivi përmban gjithashtu zëra të posaçëm për **“Linjat T/L – izolimi elektrik në linja”**, ku parashikohen punime dhe materiale të tilla si kosha/thimble, saracineska, adaptorë, por edhe elemente të lidhura me instalimet dhe furnizimin elektrik. Në vijim evidentohen kablo elektrike të tipeve dhe seksioneve të ndryshme, materiale elektrike, morseta, përcjellës dhe pajisje për realizimin e instalimeve.

Një element veçanërisht i rëndësishëm që justifikon këtë profil është fakti se preventivi parashikon pajisje elektrike dhe elektromekanike, përfshirë automate magneto-termike, automat diferencial, sinjalizues tensioni, kontaktorë, transformatorë, si dhe elemente të tjera të komandimit dhe mbrojtjes së instalimeve elektrike. Këto pajisje kërkojnë përzgjedhje, montim, lidhje, kontroll dhe verifikim teknik sipas parametrave të projektit dhe kushteve të sigurisë.

Po kështu, në analizat e çmimeve të preventivit evidentohen në mënyrë të përsëritur materiale dhe punime elektrike, si elektrosaldatrice, elektroda, kablo elektrik bakri FG7OR me seksione të ndryshme, kuti derivacioni, kuti çelës-priza, sinjalizues tensioni, automate dhe pajisje të tjera elektrike, çka tregon se komponenti elektrik nuk është një punim i izoluar apo sporadik, por shtrihet në disa zëra të realizimit të objektit.

Për rrjedhojë, Inxhinieri Elektrik është i nevojshëm për: drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve elektrike të parashikuara në preventiv; verifikimin e montimit të kabllave, përcjellësve, paneleve dhe pajisjeve elektrike; kontrollin e sistemeve të mbrojtjes, automatizimit, tokëzimit dhe furnizimit me energji; mbikëqyrjen e instalimit dhe lidhjes së pajisjeve elektromekanike të objektit; koordinimin e punimeve elektrike me punimet hidroteknike, mekanike dhe ndërtimore; kontrollin e respektimit të projektit, specifikimeve teknike dhe kërkesave të sigurisë elektrike gjatë zbatimit; kryerjen dhe ndjekjen e provave, kontrolleve dhe vënies në funksion të instalimeve elektrike përpara dorëzimit të veprës.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Mekanik** është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe zërat konkretë të punimeve të parashikuara në preventivin e objektit **“Ndërtim Ujësjiellësi për qytetin Repe”**, në të cilin, krahas punimeve civile dhe hidroteknike, parashikohen edhe punime të konsiderueshme të karakterit mekanik dhe hidromekanik, që lidhen me montimin, bashkimin, kontrollin dhe vënien në funksion të tubacioneve dhe pajisjeve të rrjetit të ujësjiellësit.

Në preventiv evidentohen punime për instalime hidro-sanitare dhe hidromekanike, si dhe përdorimi i tubave, rakorderive dhe elementeve të ndryshme të rrjetit. Gjithashtu, në analizat përkatëse përfshihen materiale dhe pajisje që kërkojnë procese montimi dhe bashkimi mekanik, çka e bën të nevojshme praninë e një specialisti të profilit mekanik për kontrollin teknik të këtyre punimeve.

Në mënyrë të veçantë, preventivi përmban zëra për saracineska dhe adaptorë me fllanxha, me diametra të ndryshëm, të cilët janë elementë funksionalë të sistemit të tubacioneve. Montimi i këtyre elementeve kërkon kontroll të përputhshmërisë së diametrave dhe parametrave teknikë, realizimin korrekt të lidhjeve me fllanxha, pozicionimin dhe montimin e pajisjeve, si dhe kontrollin e funksionimit të tyre pas instalimit.

Gjithashtu, preventivi parashikon punime me tuba çeliku, elementë metalikë, elektroda dhe procese saldimi, si dhe përdorimin e pajisjeve të saldimit. Këto punime kanë karakter të mirëfilltë mekanik dhe kërkojnë kontroll profesional mbi mënyrën e realizimit të bashkimeve, montimit të elementeve metalike dhe cilësisë së punimeve të saldimit.

Nevoja për profilin mekanik lidhet gjithashtu me instalimin dhe koordinimin e pajisjeve hidromekanike të sistemit të ujësjiellësit, të cilat duhet të funksionojnë në mënyrë të integruar me tubacionet dhe elementet e tjera të rrjetit.

Për rrjedhojë, Inxhinieri Mekanik është i nevojshëm për: drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve mekanike dhe hidromekanike të parashikuara në preventiv; kontrollin e montimit dhe bashkimit të tubacioneve dhe elementeve metalike; kontrollin e instalimit të saracineskave, adaptorëve me fllanxha, rakorderive dhe elementeve të tjera të rrjetit; mbikëqyrjen teknike të punimeve të saldimit dhe të lidhjeve mekanike të tubacioneve; kontrollin e përputhshmërisë së pajisjeve dhe materialeve mekanike me parametrat e projektit; koordinimin e instalimeve mekanike me punimet hidroteknike, civile dhe elektrike; ndjekjen e montimit, provave dhe kontrollit të funksionimit të pajisjeve dhe instalimeve përpara vënies së tyre në shfrytëzim.

Kërkesa për disponimin e **1 (një) Inxhinieri Ndërtimi, Profili Infrastrukturë e Transportit**, është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, pasi realizimi i rrjetit të ujësjiellësit kërkon ndërhyrje përgjatë infrastrukturës ekzistuese, hapjen e traseve për vendosjen e tubacioneve dhe rikthimin e sipërfaqeve të prekura në gjendjen e kërkuar teknike.

Në preventiv parashikohen në mënyrë konkrete punime gjurmimi dhe transporti, të cilat përbëjnë një pjesë të rëndësishme të realizimit të traseve të tubacioneve. Përfshihen gjurmime me ekskavator, transport materialeve dhe punime të tjera që lidhen me hapjen dhe sistemimin e traseve.

Gjithashtu, preventivi përmban kapitullin “Punime tavani dhe suvatimi” dhe, më me rëndësi për profilin e infrastrukturës, punime që lidhen me ndërhyrjen dhe rikthimin e sipërfaqeve ku zhvillohet infrastruktura e objektit. Në tërësinë e punimeve, traseja e ujësjellësit shtrihet në gjatësi të konsiderueshme: Linja e dërgimit Vepër Marrje–Depo Reps L = 5,544 ml; Linja e dërgimit Vepër Marrje–Depo Lgjin L = 646 ml; Rrjeti shpërndarës Reps L = 5,260 ml dhe Rrjeti shpërndarës Lgjin L = 1,651 ml.

Kjo shtrirje e konsiderueshme lineare e punimeve kërkon kontroll teknik të traseve, kuotave, pjerrësive, ndërhyrjeve në infrastrukturën ekzistuese dhe rikthimit të sipërfaqeve të prekura nga hapja e kanaleve.

Për rrjedhojë, Inxhinieri i Ndërtimit – Profili Infrastrukturë e Transportit është i nevojshëm për drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve që lidhen me: organizimin dhe kontrollin e punimeve përgjatë traseve të tubacioneve; gjurmimin, hapjen dhe sistemimin e kanaleve; kontrollin e mbushjeve dhe ngjeshjes së shtresave pas vendosjes së tubacioneve; kontrollin e ndërhyrjeve në rrugë dhe sipërfaqe të tjera të infrastrukturës; rikthimin e shtresave dhe sipërfaqeve të dëmtuara nga punimet; koordinimin e punimeve të ujësjellësit me infrastrukturën rrugore ekzistuese; kontrollin e zbatimit të punimeve në përputhje me kuotat, profilet dhe parametrat teknikë të projektit.

Në këto kushte, kërkesa për 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, Profili Infrastrukturë e Transportit, është e lidhur me punimet konkrete dhe shtrirjen lineare të objektit dhe është proporcionale me nevojën për drejtimin dhe kontrollin e ndërhyrjeve infrastrukturore që shoqërojnë ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit.

Inxhinier Hidroteknik – 1 (një)-Kërkesa për disponimin e 1 (një) Inxhinieri Hidroteknik është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me vetë objektin e kontratës, “Ndërtim Ujësjellësi për qytetin Reps”, dhe me pjesën kryesore të zërave të preventivit, të cilët kanë karakter të mirëfilltë hidroteknik.

Sipas preventivit përmbledhës, objekti përfshin Veprën e Marrjes, Linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Reps me gjatësi 5,544 ml, Linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Lgjin me gjatësi 646 ml, Rrjetin shpërndarës Reps me gjatësi 5,260 ml dhe Rrjetin shpërndarës Lgjin me gjatësi 1,651 ml. Këto janë komponentë tipikë dhe thelbësorë të një sistemi hidroteknik të furnizimit me ujë.

Preventivi parashikon gjithashtu zëra të drejtpërdrejtë për “Punime hidrozolimi dhe çatie”, “Instalime hidro-sanitare dhe ngrohje”, si dhe punime të tjera të lidhura me realizimin e sistemit. Një element tjetër thelbësor është prania në preventiv e saracineskave dhe adaptorëve me fllanxha të diametrave të ndryshëm, të cilët janë pjesë funksionale e linjave të ujësjellësit dhe shërbejnë për seksionimin, kontrollin dhe operimin e rrjetit. Analizat e çmimeve evidentojnë, ndër të tjera, saracineska dhe adaptorë DN 40, DN 63, DN 100 etj.

Për rrjedhojë, Inxhinieri Hidroteknik është i nevojshëm për: drejtimin dhe kontrollin teknik të realizimit të veprës së marrjes; kontrollin e ndërtimit dhe montimit të linjave të dërgimit; kontrollin e realizimit të rrjetit shpërndarës të ujësjellësit; kontrollin e vendosjes së tubacioneve sipas kuotave, profileve dhe parametrave të projektit; kontrollin e montimit të saracineskave, rakorderive, adaptorëve dhe elementeve të tjera hidraulike; koordinimin e lidhjeve ndërmjet tubacioneve dhe veprave hidroteknike; ndjekjen e provave dhe verifikimeve të tubacioneve dhe të

funksionimit të rrjetit; kontrollin e respektimit të kërkesave teknike të projektit gjatë realizimit dhe vënies në funksion të sistemit të furnizimit me ujë.

Në këtë objekt, Inxhinieri Hidroteknik përbën një profil të lidhur drejtpërdrejt me natyrën kryesore të kontratës, pasi pjesa thelbësore e saj konsiston në ndërtimin e një sistemi ujësjellësi, nga vepra e marrjes dhe linjat e dërgimit deri te rrjetet shpërndarëse dhe elementet përkatëse hidraulike.

Kërkesat e përcaktuara për stafin teknik dhe punonjësit e specializuar janë hartuar në funksion të garantimit të kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin me cilësi, siguri dhe brenda afateve të punimeve objekt kontrate.

Në përcaktimin e tyre është mbajtur në konsideratë **neni 77 i Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar**, sipas të cilit, në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor mund të vendosë kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**.

Gjithashtu, kriteret mbështeten në **nenin 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar**, lidhur me kontratat për punë publike, sipas të cilit kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me **aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës**.

Në rastin konkret, objekti **“Ndërtim Ujësjellësi për qytetin Repe”** përfshin një volum dhe shumëllojshmëri të konsiderueshme punimesh, ndër të cilat: vepër marrjeje, linja dërgimi, rrjete shpërndarëse, gërmime, transport dhe largim materialesh, punime betoni dhe betonarmeje, kallëpe, armaturë, muraturë, suvatime, instalime hidraulike dhe hidromekanike, montim tubacionesh, punime elektrike, si dhe ndërhyrje dhe rehabilitim të sipërfaqeve të prekura nga punimet.

Për këtë arsye, personeli i kërkuar është përcaktuar sipas proceseve konkrete të punës dhe nevojës për organizimin e njëkohshëm dhe të vazhdueshëm të kantierit.

1. Drejtuesi Teknik i punimeve – 1 (një)

Kërkesa që operatori ekonomik të përcaktojë një **Drejtues Teknik të punimeve**, inxhinier me eksperiencë dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë, është e lidhur drejtpërdrejt me nevojën për organizimin, drejtimin dhe kontrollin teknik të zbatimit të punimeve në kantier.

Drejtuesi Teknik është i nevojshëm për të garantuar që punimet të realizohen në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, kushtet teknike të zbatimit dhe kërkesat e sigurisë, si dhe për koordinimin e profileve të ndryshme profesionale të angazhuara në objekt.

Kjo kërkesë lidhet gjithashtu me kuadrin ligjor që rregullon **kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit**, sipas të cilit zbatimi i punimeve duhet të kryhet në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të zbatimit.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen dhe kompleksitetin e objektit, kërkesa që Drejtuesi Teknik të jetë i pranishëm gjatë realizimit të punimeve synon garantimin e një drejtimi teknik efektiv dhe të vazhdueshëm të kantierit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, përcaktimi i Drejtuesit Teknik nga secili anëtar, në varësi të punimeve dhe përqindjes që ka marrë përsipër, lidhet me nevojën që secila pjesë e kontratës të realizohet nën përgjegjësinë teknike të subjektit që do ta zbatojë atë.

2. Teknik Ndërtimi – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Teknikë Ndërtimi lidhet me volumin dhe shumëllojshmërinë e punimeve civile të parashikuara në preventiv.

Objekti përmban punime gjurmimi, struktura betoni dhe betonarmeje, muraturë, kallëpe, armaturë, prishje dhe rikthim të elementeve ndërtimore, si dhe punime të tjera civile që zhvillohen në pika dhe fronte të ndryshme pune.

Dy teknikët janë të nevojshëm për ndjekjen operative të proceseve të punës në terren, kontrollin e zbatimit të detajeve teknike, matjen e volumeve të realizuara dhe koordinimin e skuadrave të punës.

Numri prej 2 teknikësh konsiderohet proporcional, duke marrë në konsideratë shtrirjen lineare të objektit dhe mundësinë e zhvillimit të punimeve në më shumë se një front pune.

3. Teknik Topograf – 1 (një)

Kërkesa për 1 (një) Teknik Topograf është e domosdoshme për shkak të karakterit linear të objektit. Linjat e dërgimit dhe rrjetet shpërndarëse kanë një gjatësi të konsiderueshme dhe kërkojnë piketimin e aksit, kontrollin e kuotave, thellësive të gjurmimit, pjerrësive dhe pozicionit të tubacioneve dhe veprave përkatëse.

Tekniku Topograf do të shërbejë për materializimin në terren të të dhënave të projektit dhe kontrollin gjeometrik të punimeve gjatë zbatimit.

4. Hidraulik – 3 (tre)

Kërkesa për 3 (tre) hidraulikë lidhet drejtpërdrejt me objektin kryesor të kontratës, që është ndërtimi i një sistemi ujësjellësi.

Punimet përfshijnë linja dërgimi dhe rrjete shpërndarëse, montimin e tubacioneve, rakorderive, saracineskave, adaptorëve dhe elementeve të tjera të sistemit.

Për shkak të shtrirjes së konsiderueshme të rrjetit dhe zhvillimit të punimeve në fronte të ndryshme, është e nevojshme disponueshmëria e një grupi minimal prej 3 hidraulikësh, me qëllim realizimin e montimeve dhe lidhjeve hidraulike në mënyrë profesionale dhe brenda afatit të kontratës.

5. Specialist për montim tubash – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Specialistë për montim tubash është e lidhur drejtpërdrejt me volumin e tubacioneve që duhet të instalohen.

Objekti përfshin linja dërgimi dhe rrjete shpërndarëse me gjatësi të konsiderueshme, çka kërkon procese të vazhdueshme të transportimit, pozicionimit, bashkimit dhe montimit të tubave dhe elementeve lidhëse.

Specialistët duhet të sigurojnë realizimin korrekt të bashkimeve, montimin e rakorderive dhe elementeve të tjera, duke shmangur defektet që mund të shkaktojnë rrjedhje apo probleme gjatë shfrytëzimit të rrjetit.

Kërkesa për 2 specialistë është minimale dhe proporcionale me shtrirjen e tubacioneve.

6. Murator – 1 (një)

Kërkesa për 1 (një) murator argumentohet me zërat e preventivit që përmbajnë punime murature dhe punime ndërtimore plotësuese.

Muratori nevojitet për realizimin e mureve, riparimeve dhe elementeve ndërtimore të veprave të rrjetit, përfshirë ndërhyrjet në objektet dhe strukturat ndihmëse.

Duke marrë në konsideratë që muratura nuk përbën volumin kryesor të kontratës, është kërkuar vetëm 1 punonjës, duke ruajtur proporcionalitetin e kriterit.

7. Betonues – 3 (tre)

Kërkesa për 3 (tre) betonues lidhet me volumin e punimeve të betonit dhe betonarmesë të parashikuara në preventiv.

Preventivi përmban kapitull të posaçëm për “Punime betoni e betonarmeje”, ku evidentohen struktura monolite betoni të klasave të ndryshme dhe elemente të tjera prej betoni.

Këto punime kërkojnë përgatitjen, hedhjen, vibrimin, nivelimin dhe trajtimin e betonit. Për këtë arsye, disponimi i 3 betonuesve është i nevojshëm për realizimin e proceseve teknologjike të betonimit dhe për organizimin e skuadrës së punës.

8. Suvatues – 1 (një)

Kërkesa për 1 (një) suvatues lidhet me zërat e preventivit për punimet e suvatimit dhe rifiniturës.

Ky punonjës është i nevojshëm për realizimin e sipërfaqeve të suvatuara dhe riparimin e elementeve të prekura nga ndërhyrjet ndërtimore.

Duke qenë se këto punime kanë peshë më të kufizuar krahasuar me punimet kryesore të ujësjiellit, kërkesa është kufizuar në 1 suvatues.

9. Karpentier – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) karpentierë lidhet drejtpërdrejt me punimet e betonarmesë, për të cilat nevojitet realizimi dhe montimi i kallëpeve.

Karpentierët janë të nevojshëm për përgatitjen, montimin, përforcimin dhe çmontimin e kallëpeve për strukturat e betonit dhe betonarmesë të parashikuara në preventiv.

Numri prej 2 punonjësish është përcaktuar në funksion të realizimit normal të këtyre proceseve dhe koordinimit të tyre me betonuesit dhe hekurkthyesit.

10. Hekurkthyes – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) hekurkthyes është e lidhur me punimet e betonarmesë dhe përdorimin e armaturës së çelikut.

Hekurkthyesit janë të nevojshëm për prerjen, kthimin, përgatitjen dhe montimin e armaturës sipas detajeve të projektit përpara realizimit të betonimit.

Këta punonjës funksionojnë në koordinim me karpentierët dhe betonuesit, ndaj kërkesa për 2 hekurkthyes është e lidhur drejtpërdrejt me organizimin teknologjik të punimeve të betonarmesë.

11. Punëtorë për punime në rrugë dhe asfaltim – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) punëtorë për punime në rrugë dhe asfaltim lidhet me faktin se ndërtimi i rrjetit të ujësjiellit kërkon hapjen e kanaleve përgjatë traseve dhe ndërhyrje në sipërfaqe rrugore.

Pas vendosjes së tubacioneve është e nevojshme mbyllja e kanaleve dhe rikthimi i sipërfaqeve të prekura nga punimet.

Për këtë arsye, këta punonjës janë të nevojshëm për proceset e sistemit dhe rehabilitimit të sipërfaqeve rrugore pas përfundimit të punimeve nëntokësore.

Numri prej 2 punonjësish është minimal dhe proporcional me natyrën e këtyre punimeve.

12. Shoferë – 3 (tre)

Kërkesa për 3 (tre) shoferë, të pajisur me kategoritë përkatëse të lejes së drejtimit, lidhet me nevojën për transportimin e materialeve, tubacioneve, dherave dhe materialeve të dala nga gërmimi, si dhe furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës.

Preventivi parashikon shprehimisht punime transporti të materialeve dhe dherave, ndërsa shtrirja lineare e objektit kërkon lëvizjen e vazhdueshme të materialeve ndërmjet pikave të furnizimit dhe fronteve të punës.

Për këtë arsye, disponueshmëria e 3 shoferëve është e lidhur me nevojën për përdorimin efektiv të mjeteve të transportit të kërkuara për realizimin e kontratës.

Kërkesa për leje drejtimi të kategorive përkatëse garanton që mjetet të drejtohen nga persona të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

13. Manovrator Eskavatorist – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Eskavatoristë lidhet drejtpërdrejt me volumin e punimeve të gërmimit.

Preventivi përmban punime të konsiderueshme gërmimi me mjete mekanike për hapjen e kanaleve të tubacioneve dhe realizimin e veprave përkatëse.

Duke qenë se rrjeti shtrihet në një gjatësi të konsiderueshme dhe punimet mund të zhvillohen paralelisht në fronte të ndryshme, kërkesa për 2 eskavatoristë garanton shfrytëzimin e makinerive të gërmimit dhe vazhdimësinë e procesit teknologjik.

14. Manovrator Automakinist – 2 (dy)

Kërkesa për 2 (dy) Automakinistë është e lidhur me përdorimin e makinerive dhe mjeteve të parashikuara për transport, ngarkim-shkarkim, sistemim dhe procese të tjera të mekanizuara në kantier.

Punimet e objektit karakterizohen nga zhvendosja e volumeve të materialeve dhe nga nevoja për furnizimin e vazhdueshëm të fronteve të punës.

Për këtë arsye, kërkesa për 2 automakinistë është e lidhur me kapacitetin real të operatorit për të vënë në përdorim makineritë e deklaruara për realizimin e kontratës.

15. Manovrator Buldozerist – 1 (një)

Kërkesa për 1 (një) Buldozerist lidhet me proceset e punimeve në tokë, sistemimin e terrenit, shtyrjen dhe shpërndarjen e materialeve dhe përgatitjen e sipërfaqeve të punës.

Duke qenë se buldozeri ka funksion specifik në organizimin e punimeve të tokës dhe nuk kërkohet përdorimi i disa mjeteve të tilla njëkohësisht, është përcaktuar vetëm 1 buldozerist, duke respektuar parimin e proporcionalitetit.

Kërkesa për kontratën e punës, dokumentacionin që vërteton kualifikimin profesional dhe, sipas rastit, dokumentacionin e aftësisë profesionale, ka për qëllim të provojë se operatori ekonomik disponon realisht burimet njerëzore të deklaruara dhe se personat e angazhuar kanë kualifikimin e nevojshëm për kryerjen e proceseve përkatëse të punës.

Kërkesa që punonjësit e specializuar të jenë të përfshirë në listëpagesat e operatorit ekonomik për periudhën e kërkuar synon të provojë ekzistencën dhe disponibilitetin real të personelit dhe jo vetëm paraqitjen formale të tij për efekt të procedurës së prokurimit.

Për manovratorët, kërkesa për Dëshmi të Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e makinerive që do të përdoren dhe nevojën që ato të operohen nga personel i kualifikuar dhe i autorizuar.

Në rastet kur mjeti është marrë me qira së bashku me personelin që e operon, parashikimi që punonjësi të mund të angazhohet nëpërmjet kontratës përkatëse lidhet me faktin se operatori ekonomik duhet të provojë disponueshmërinë efektive të burimit njerëzor dhe teknik gjatë zbatimit të kontratës, pa qenë e nevojshme që pronësia e mjetit apo marrëdhënia e punësimit të kufizohet vetëm te operatori ofertues.

f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (ne rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- Minimumi 1 (një) punonjes të certifikuar me dëshmi trajnimi si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në Punë”** të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara

nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qellim. Mjeket duhet të jenë të pajisur me licencë profesionale të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes. Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë minimumi **1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë** është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën, kompleksitetin dhe rreziqet që paraqesin punimet objekt kontrate.

Objekti "**Ndërtim Ujësjiellësi për qytetin Rejs**" përfshin punime të shumëllojshme ndërtimore dhe infrastrukturore, ndër të cilat: gjurmime mekanike dhe manuale, hapje kanalesh për tubacionet, transport dhe largim materialesh, punime betonarmeje, montim tubacionesh dhe elementesh hidromekanike, punime elektrike, ndërhyrje në sipërfaqe rrugore, si dhe përdorim të makinerive të rënda të ndërtimit.

Preventivi parashikon në mënyrë konkrete punime gjurmimi me ekskavator, transport dherash dhe materialesh, punime strukturore, betonarmeje, instalime të ndryshme dhe punime të tjera që realizohen në kantier.

Gjithashtu, objekti ka një shtrirje të konsiderueshme territoriale, pasi përfshin: linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Rejs me gjatësi rreth **5,544 ml**; linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Lgjin me gjatësi rreth **646 ml**; rrjetin shpërndarës Rejs me gjatësi rreth **5,260 ml**; rrjetin shpërndarës Lgjin me gjatësi rreth **1,651 ml**.

Kjo shtrirje nënkupton hapjen dhe funksionimin e disa fronteve të punës dhe ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve të ndryshme gjatë realizimit të punimeve.

Në mënyrë të veçantë, natyra e punimeve krijon rreziqe që lidhen me: punimet në gjurmime dhe kanale; shembjen e mundshme të skarpateve ose anëve të kanalit; lëvizjen e makinerive të rënda dhe mjeteve të transportit; ngritjen, transportimin dhe montimin e tubacioneve dhe pajisjeve; punimet me beton dhe armaturë; përdorimin e pajisjeve elektrike dhe mekanike; punimet në ose pranë segmenteve rrugore; lëvizjen e punonjësve dhe mjeteve në të njëjtën zonë pune; përdorimin e mjeteve të punës dhe pajisjeve potencialisht të rrezikshme; organizimin e punimeve në fronte të ndryshme të kantierit.

Pikërisht për shkak të këtyre proceseve, kërkohet një person i kualifikuar që të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse në kantier.

Punonjësi përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë do të ketë rol në evidentimin dhe vlerësimin e rreziqeve, kontrollin e përdorimit të pajisjeve mbrojtëse individuale dhe kolektive, zbatimin e rregullave të sigurisë në gjurmime, përdorimin e makinerive dhe mjeteve të punës, sinjalistikën e kantierit, organizimin e lëvizjes së mjeteve dhe punonjësve dhe marrjen e masave parandaluese ndaj aksidenteve.

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin nr. 10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, të ndryshuar, i cili përcakton detyrimet e punëdhënësit për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve, si dhe në VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, e cila përcakton kërkesat e sigurisë që duhet të zbatohen në kantieret e ndërtimit.

Për rrjedhojë, kërkesa për minimumi 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë nuk është një kërkesë formale, por është e diktuar nga karakteristikat konkrete të objektit, numri i proceseve të rrezikshme, përdorimi i makinerive të rënda dhe nevoja për monitorim të vazhdueshëm të kushteve të sigurisë gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve.

Numri prej 1 (një) punonjësi është proporcional me objektin e kontratës, pasi siguron ekzistencën e një përgjegjësi të identifikueshëm për koordinimin dhe kontrollin e masave të sigurisë, pa vendosur një barrë të panevojshme mbi operatorët ekonomikë.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë mjek të shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë nëpërmjet kontratës së shërbimit me një subjekt të specializuar lidhet me natyrën e punimeve dhe me nevojën për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen shëndetësore të punonjësve të angazhuar në realizimin e kontratës.

Punimet objekt kontrate janë punime ndërtimore dhe infrastrukturore të realizuara kryesisht në terren dhe përfshijnë një numër procesesh që krijojnë ekspozim të drejtpërdrejtë të punëmarrësve ndaj faktorëve të ndryshëm të riskut profesional.

Në këto punime përfshihen, ndër të tjera, gjurmime, punime në kanale, transport dhe ngarkim-shkarkim materiale, punime betonarme, montim tubacionesh, përdorim makinerish të rënda, punime mekanike, elektrike dhe ndërhyrje në rrugë.

Gjatë këtyre proceseve, punonjësit mund të ekspozohen ndaj faktorëve të tillë si: pluhura dhe grimca të krijuara gjatë gjurmimeve dhe punimeve të ndërtimit; zhurma dhe vibrimet nga makineritë e rënda; ngarkesa fizike gjatë transportit dhe montimit të materialeve; temperatura të larta ose të ulëta gjatë punës në ambient të hapur; rreziku nga goditjet, rrëzimet apo aksidentet

mekanike;ekspozimi ndaj pajisjeve dhe mjeteve të punës;risku që lidhet me punimet elektrike;lodhja fizike dhe faktorët ergonomikë gjatë proceseve të punës.

Për këtë arsye, kontrolli shëndetësor i punonjësve është një element plotësues i sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe shërben për të vlerësuar përshtatshmërinë shëndetësore të punonjësve për detyrat që kryejnë, si dhe për parandalimin e dëmtimeve të shëndetit që mund të lidhen me ekspozimin profesional.

Kërkesa për mjekun lidhet në mënyrë të veçantë me faktin se operatori ekonomik do të angazhojë personel të profileve të ndryshme, përfshirë teknikë, hidraulikë, montues tubash, betonues, karpentierë, hekurkthyes, punëtorë të rrugës, shoferë, eskavatoristë, automakinistë dhe buldozeristë, të cilët kryejnë detyra me nivele të ndryshme të ekspozimit ndaj riskut profesional.

Mjeku i punës/shoqërisë ka rëndësi për ndjekjen e gjendjes shëndetësore të punëmarrësve në raport me risqet e vendit të punës, këshillimin për masat parandaluese dhe kryerjen e kontrollit shëndetësor sipas kërkesave të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Legjislacioni në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë parashikon masa për kontrollin shëndetësor të punëmarrësve, ndërsa kuadri nënligjor përcakton detyrimet e punëdhënësit për sigurimin e këtij kontrolli. Për këtë arsye, kërkesa për disponimin e shërbimit mjekësor duhet të konsiderohet si masë e lidhur me mbrojtjen shëndetësore të personelit që do të angazhohet në kantiër.

- 2.3.4.** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Liçencat e nevojshme (lëshuar nga QKL), për zbatimin e punimeve objekt kontrate, për përmbushjen e të cilit duhet të paraqesë dokumentacionin si me poshte:
- Liçensë të lëshuar nga Qendra Kombetare e Liçencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: *Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë Licencën e QKB-së kategoria III.2.B është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e objektit të prokurimit.*

Kërkesa që operatori ekonomik pjesëmarrës të disponojë Licencë Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte” është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën dhe proceset teknologjike të punimeve të parashikuara në preventivin e objektit “Ndërtim Ujësjiellësi për qytetin Reps”.

Nga preventivi rezulton se realizimi i objektit përfshin punime të konsiderueshme gjurmimi, hapje kanalesh, ngarkim, transport dhe sistemim materialesh, të domosdoshme për vendosjen e tubacioneve të linjave të dërgimit dhe të rrjeteve shpërndarëse.

Objekti ka gjithashtu një shtrirje të konsiderueshme lineare, pasi përfshin linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Reps me gjatësi 5,544 ml, linjën Vepër Marrje–Depo Lgjin me gjatësi 646 ml, rrjetin shpërndarës Reps me gjatësi 5,260 ml dhe rrjetin shpërndarës Lgjin me gjatësi 1,651 ml. Për realizimin e këtyre traseve është i pashmangshëm krijimi i materialeve të dala nga gjurmimet, si dhe, sipas zonave ku kryhen ndërhyrjet, materialeve inerte që mund të rezultojnë nga prishja

ose heqja e shtresave ekzistuese, elementeve prej betoni, materialeve të mbushjes apo shtresave rrugore të prekura nga punimet.

Jo i gjithë materiali i nxjerrë nga gërmimi mund të ripërdoret në mbushjen e kanaleve. Materialet e papërshtatshme, tepricat e gërmimit dhe materialet inerte të dala nga ndërhyrjet duhet të grumbullohen, ngarkohen, transportohen dhe depozitohen në mënyrë të kontrolluar, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Për këtë arsye, disponimi i licencës përkatëse synon të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitetin dhe autorizimin e nevojshëm për administrimin e kësaj faze të punimeve, duke shmangur: depozitimin e pakontrolluar të materialeve inerte në kantier ose përgjatë traseve; hedhjen e materialeve në vende të paautorizuara; pengimin e qarkullimit dhe zhvillimit normal të punimeve nga grumbullimi i dherave dhe mbetjeve; krijimin e rreziqeve për mjedisin dhe sigurinë në kantier; transportimin e materialeve inerte nga subjekte të paautorizuara.

Kërkesa është veçanërisht e lidhur me faktin se preventivi parashikon përdorimin e mjeteve dhe makinerive për gërmim dhe transport, çka tregon se largimi dhe zhvendosja e materialeve të dala nga punimet përbën një proces real të zbatimit të kontratës dhe jo një kërkesë të shkëputur nga objekti.

Për rrjedhojë, kërkesa për Licencën Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte” është e justifikuar nga natyra e punimeve, pasi gjatë realizimit të rrjetit të ujësjellësit gjenerohen materiale të dala nga gërmimet dhe ndërhyrjet në infrastrukturën ekzistuese, një pjesë e të cilave duhet të largohen nga kantieri dhe të transportohen drejt vendeve të përcaktuara për administrimin e tyre.

Kriteri synon të sigurojë që procesi i largimit dhe transportimit të këtyre materialeve të kryhet nga një operator që disponon të drejtën për ushtrimin e kësaj veprimtarie, duke garantuar menaxhimin e rregullt të kantierit, mbrojtjen e mjedisit dhe vijueshmërinë normale të punimeve.

Rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë

Në rastin e një bashkimi operatorësh ekonomikë, kërkesa për licencën përkatëse duhet të lidhet me ndarjen konkrete të punimeve të marrë përsipër nga secili anëtar, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe preventivit.

Për rrjedhojë, operatori/anëtari i bashkimit që, sipas ndarjes së punimeve, do të realizojë aktivitetet që përfshijnë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve inerte, duhet të disponojë licencën përkatëse për këtë veprimtari. Kjo siguron që kapaciteti i kërkuar të lidhet drejtpërdrejt me pjesën e kontratës që secili anëtar ka marrë përsipër dhe ruan proporcionalitetin e kriterit me përgjegjësitë konkrete të secilit subjekt.

2.3.5 Makineri Pajisje

Operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, si me poshtë (sipas formularit përmbledhës të vetedeklarimit):

Nr	Emri i mjetit	Njesia	Sasia/cope	Statusi
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10-15 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 15-20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 - 5 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
6	Minidamper me goma me kapacitet deri në 4 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera

9	Autopompe betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Makineri per prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Makineri per kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Eskavator me goma	copë	2	Në pronësi ose me qera
14	Fadromë me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Minifadrome /Bobcat me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Autobot uji	cope	1	Në pronësi ose me qera
17	Asfaltoshtruese	cope	1	Në pronësi ose me qera
18	Autobitumatrice	cope	1	Në pronësi ose me qera
19	Grejder me goma	cope	1	Në pronësi ose me qera
20	Rul Gome - hekur 15 - 18 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
21	Rul gomë gomë per asfaltme 10-12 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
22	Rul gomë gomë per asfaltme 14-16 ton	cope	1	Në pronësi ose me qera
23	Gjenerator / Motogjenerator	cope	2	Në pronësi ose me qera
24	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	cope	2	Në pronësi ose me qera
25	Paisje / Instrument i kombinuar për matjen e pH, oksigjenit (O ₂), temperaturës, turbullirës dhe mbetjes së klorit	cope	2	Në pronësi ose me qera
26	Pajisje gjeodezike GPS	cope	1	Në pronësi ose me qera
27	Kontenier ndertimi stacionar (zyre)	cope	1	Në pronësi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jeleke fosforoshente minimumi 40 cope
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 7 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten e verifikimit te saktësisese informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do te konsiderohet kusht për skualifikim.

Shënim: Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njohsuara me origjinalin, si më poshtë:

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njohsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata perkatëse e qerasë, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar në këtë procedurë prokurimi nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: "Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Kërkesat për makineritë, mjetet dhe pajisjet janë përcaktuar në funksion të natyrës, volumit dhe shtrirjes territoriale të punimeve objekt kontrate, me qëllim që operatori ekonomik të provojë se disponon kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin e punimeve sipas preventivit dhe brenda afatit të kontratës.

Objekti përfshin një sistem të gjerë ujësjellësi me gjatësi të përgjithshme lineare rreth 13,101 ml, vepër marrjeje, depo uji, linja transmetimi dhe rrjete shpërndarëse. Krahas montimit të tubacioneve, preventivi përmban volume të konsiderueshme gërmimi, transporti, mbushjeje dhe ngjeshjeje, punime betoni e betonarmeje, hekur armature, punime metalike, shtresa rrugore, instalime hidromekanike dhe elektrike.

1. Kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton – 1 copë

Kërkesa për 1 kamion vetëshkarkues me kapacitet jo më pak se 20 ton lidhet me volumin e konsiderueshëm të materialeve që duhet të transportohen gjatë realizimit të punimeve.

Në preventiv parashikohen zëra të përsëritur për transport dheu me auto, si dhe volume të konsiderueshme gërmimi. Vetëm për linjën e dërgimit Vepër Marrje–Depo Reps evidentohen volume gërmimi prej 775 m³, 1,163 m³, 970 m³, 1,454 m³, 1,382 m³, 242 m³ dhe 3,775 m³, sipas kategorive të ndryshme të tokës dhe proceseve të punës.

Në rrjetin shpërndarës Reps parashikohen gjithashtu volume të mëdha, si 821 m³, 525 m³, 525 m³, 870 m³, 53 m³ dhe 1,653 m³, krahas zërit të transportit të dheut.

Për rrjedhojë, një kamion me kapacitet të madh është i nevojshëm për largimin ekonomik dhe të shpejtë të dherave, materialeve inerte dhe transportin e agregateve në distanca më të mëdha, duke reduktuar numrin e cikleve të transportit.

2. Kamion vetëshkarkues 10–15 ton – 2 copë

Kërkesa për 2 kamionë vetëshkarkues 10–15 ton lidhet me nevojën për furnizimin paralel të fronteve të punës me materiale dhe largimin e materialeve të gërmimit.

Preventivi parashikon në mënyrë të përsëritur zëra për transportin e materialeve me distanca 5 km dhe 10 km, të evidentuara edhe në analizat e çmimeve të tubacioneve, saracineskave, adaptorëve dhe punimeve të tjera.

Dy mjete të kësaj kategorie lejojnë punën në dy fronte të ndryshme, gjë që lidhet me shtrirjen prej mbi 13 km të rrjetit dhe me faktin se punimet e gërmimit, furnizimit dhe mbushjes zhvillohen në mënyrë të vazhdueshme përgjatë traseve.

3. Kamion vetëshkarkues 15–20 ton – 1 copë

Ky mjet plotëson kapacitetin e transportit për volumet e konsiderueshme të dherave, çakëllit, stabilizantit dhe materialeve të tjera masive.

Në analizat e preventivit evidentohet transporti i materialeve, ndërsa në disa zëra parashikohen shtresa çakëlli, stabilizanti dhe binderi me granil guri. Për shembull, në analizën e një kalimi të tubacionit parashikohen 10 m³ transport dheu, 10 m² shtresë çakëlli, 10 m² shtresë stabilizanti dhe 10 m² shtresë binderi.

Kapaciteti 15–20 ton është i përshtatshëm për transportin e materialeve masive pa qenë e nevojshme përdorimi i vazhdueshëm i kamionit të kategorisë më të madhe.

4. Kamion vetëshkarkues 3.5–5 ton – 2 copë

Kamionët me kapacitet më të vogël janë të nevojshëm për furnizimin e fronteve të punës me akses të kufizuar, ku përdorimi i kamionëve të tonazhit të madh mund të jetë teknikisht i vështirë.

Objekti ka karakter linear, me tubacione që kalojnë në zona të ndryshme dhe me shumë pika të veçanta pune, si puseta, nyje, saracineska dhe lidhje individuale. Preventivi përmban një numër të konsiderueshëm pusetash dhe elementësh të shpërndarë në të gjithë rrjetin.

Për këtë arsye, 2 mjete të vogla mundësojnë furnizimin lokal me agregate, beton, materiale dhe pajisje pa bllokuar organizimin e kantierit.

5. Autovinc – 1 copë

Autovinci është i nevojshëm për ngritjen, shkarkimin, pozicionimin dhe montimin e tubacioneve, elementeve metalike dhe pajisjeve hidromekanike.

Në preventiv përfshihen tuba çeliku me diametra mbi 200 mm, saracineska, adaptorë me fllanxha, elemente metalike, panele dhe pajisje të tjera që për shkak të peshës nuk mund të manipulohen në mënyrë të sigurt vetëm manualisht. Analizat për kalimet e tubacioneve parashikojnë tuba çeliku Ø219 mm, Ø159 mm, Ø82.5 mm dhe Ø70.5 mm.

Prandaj, 1 autovinc është i justifikuar për operacionet e ngritjes dhe montimit të elementeve të rënda në pikat ku kërkohet.

6. Minidamper me goma deri në 4 ton – 1 copë

Minidamperi nevojitet për transport lokal të dherave, zhavorrit, çakëllit dhe materialeve të tjera në zona ku kamionët nuk kanë akses të drejtpërdrejtë.

Preventivi parashikon punime të shumta në kanale dhe puseta, përfshirë mbushje, rrafshim dhe ngjeshje të dheut, çka kërkon transport të materialeve në distanca të shkurtra brenda kantierit.

7. Betoniere – 1 copë

Kërkesa lidhet me volumin dhe shpërndarjen e punimeve të betonit.

Preventivi përmban kapituj të posaçëm për “Punime betoni e betonarmeje”, ku përfshihen struktura monolite betoni C12/15, C16/20, C25/30 etj.

Betonierja është e nevojshme veçanërisht për përgatitjen e volumeve të vogla dhe të mesme të betonit në pika të shpërndara të objektit, ku furnizimi me autobetonierë nuk është gjithmonë ekonomik.

8. Autobetonierë – 2 copë

Kërkesa për 2 autobetoniera lidhet me volumet e punimeve të betonit dhe betonarmesë në veprën e marrjes, depot, pusetat dhe strukturat e tjera.

Në preventiv evidentohen qindra metra kub punime betonarmeje dhe struktura monolite; në rrjetin shpërndarës Reps paraqitet ndër të tjera edhe një volum prej 344 m³ në grupin e punimeve të betonit dhe betonarmesë.

Dy autobetoniera sigurojnë vazhdimësinë e furnizimit gjatë betonimeve dhe shmangin ndërprerjet që mund të cenojnë cilësinë e elementeve monolite.

9. Autopompë betoni – 2 copë

Autopompa është e nevojshme për hedhjen e betonit në elemente ku shkarkimi direkt nga autobetoniera nuk është i mundur.

Punimet përfshijnë struktura monolite, depo, puseta, mure dhe elemente të ndryshme betonarmeje, të shpërndara në zona të ndryshme të kantierit.

Disponimi i 2 autopompave lidhet me mundësinë e zhvillimit të betonimeve në fronte të ndryshme dhe me nevojën për vazhdimësi teknologjike.

10. Vibrator betoni – 2 copë

Vibratorët janë të domosdoshëm për ngjeshjen e betonit të freskët, eliminimin e boshllëqeve dhe sigurimin e homogjenitetit të strukturave.

Duke qenë se preventivi ka volume të konsiderueshme betoni dhe betonarmeje, kërkesa për 2 vibratorë është e lidhur drejtpërdrejt me procesin teknologjik të betonimit.

11. Makineri për prerje hekuri ndërtimi – 1 copë

12. Makineri për kthim hekuri ndërtimi – 1 copë

Të dyja pajisjet lidhen me zërat e hekurit të betonit dhe betonarmesë.

Preventivi përmban zëra të posaçëm për hekur betoni periodik Ø>12 mm, si dhe armaturë të përdorur në struktura dhe puseta. Në analizat e pusetave parashikohen në mënyrë konkrete sasi hekuri për strukturat betonarme.

Prerja dhe kthimi i shufrave sipas dimensioneve të projektit janë procese teknologjike të domosdoshme; ndaj kërkesa për nga 1 pajisje për secilin proces është minimale dhe proporcionale.

13. Eskavator me goma – 2 copë

Kjo është ndër pajisjet kryesore të objektit.

Preventivi përmban volume shumë të larta gërmimi me ekskavator. Vetëm linja e dërgimit Reps përmban disa mijëra m³ gërmime, ndërsa në rrjetin shpërndarës Reps evidentohen po ashtu disa mijëra m³.

Për shkak të 13.1 km trase tubacionesh, kërkesa për 2 eskavatorë lidhet me nevojën për hapjen paralelisht të kanaleve në më shumë se një front pune dhe për respektimin e afatit të kontratës.

14. Fadromë me goma – 1 copë

Fadroma është e nevojshme për ngarkimin e dherave në kamionë, lëvizjen e agregateve, nivelimin fillestar dhe sistemimin e materialeve.

Zërat e gërmimit dhe transportit kanë volume të konsiderueshme, ndaj ngarkimi i materialeve vetëm me eskavator do të kufizonte produktivitetin e kantierit.

15. Minifadromë/Bobcat – 1 copë

Minifadroma është e nevojshme për punë në zona të ngushta dhe pranë pusetave, ndërtesave, depove apo segmenteve urbane ku fadroma standarde nuk mund të operojë me lehtësi.

Shpërndarja e madhe e pusetave, nyjeve hidraulike dhe lidhjeve të veçanta në rrjet e justifikon 1 pajisje kompakte për ngarkim, sistemim dhe pastrim lokal të fronteve.

16. Autobot uji – 1 copë

Autoboti i ujit lidhet me ngjeshjen e shtresave të mbushjes dhe të bazës, kontrollin e lagështisë së materialeve, uljen e pluhurit dhe pastrimin e zonave të punës.

Në preventiv parashikohen në mënyrë të përsëritur mbushje, rrafshim dhe ngjeshje me tokmak elektrik, shtresa çakëlli dhe shtresa stabilizanti.

Lagështimi i kontrolluar është pjesë e procesit teknologjik për arritjen e ngjeshjes së kërkuar.

17. Asfaltoshtruese – 1 copë

18. Autobitumatrice – 1 copë

19. Grejder me goma – 1 copë

20. Rul gomë-hekur 15–18 ton – 1 copë

21. Rul për asfaltime 10–12 ton – 1 copë

22. Rul për asfaltime 14–16 ton – 1 copë

Këto pajisje lidhen me rikthimin e shtresave rrugore të prekura nga hapja e traseve të ujësjiellësit. Preventivi parashikon zëra konkretë për formimin e shtresave pas gërmimit, përfshirë shtresë çakëlli, shtresë stabilizanti dhe shtresë binderi me granil guri, si dhe punime me material bituminoz/emulsion. Në analizat e preventivit shfaqen konkretisht shtresa çakëlli, stabilizanti dhe binderi, ndërsa në një numër të madh analizash të kalimeve parashikohet edhe “H/Izolim me emulsion, 2 duar bitum”.

Në këtë proces: Grejderi shërben për profilimin dhe nivelimin e shtresave; Autobitumatricja për shpërndarjen uniforme të materialit bituminoz; Asfaltoshtruesja për shtrimin mekanik dhe uniform të shtresës asfaltike/binderit aty ku kërkohet rikthimi i sipërfaqes; Ruli 15–18 ton për ngjeshjen e shtresave të bazës dhe stabilizantit; rulat e asfaltimit për ngjeshjen progresive dhe përfundimtare të shtresave bituminoze.

Prania e kapaciteteve të ndryshme të rulave lidhet me fazat e ndryshme të ngjeshjes dhe nuk përfaqëson të njëjtin funksion teknik.

23. Gjenerator/Motogjenerator – 2 copë

Gjeneratorët janë të nevojshëm për furnizimin me energji të pajisjeve të kantierit në fronte të shpërndara ku nuk garantohej furnizim i qëndrueshëm me energji elektrike.

Objekti ka shtrirje mbi 13 km dhe preventivi përmban pajisje dhe procese elektrike, saldimi, prerjeje, vibrimi dhe mjete të tjera elektrike. Përveç kësaj, në preventiv evidentohen instalime të mirëfillta elektrike dhe pajisje komandimi.

Kërkesa për 2 gjeneratorë lejon furnizimin e dy fronteve të punës njëkohësisht.

24. Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice – 2 copë

Kërkesa lidhet drejtpërdrejt me tubacionet dhe konstruksionet metalike.

Preventivi përmban zëra për tuba çeliku Ø>200 mm, tuba çeliku të diametrave të ndryshëm, profile metalike, elektroda dhe punime metalike. Analizat e kalimeve përfshijnë konkretisht tuba çeliku Ø219 mm, Ø159 mm, Ø82.5 mm dhe Ø70.5 mm.

Dy pajisjet justifikohen nga mundësia e kryerjes së montimeve dhe saldimeve në dy fronte të ndryshme.

25. Pajisje/instrument i kombinuar për matjen e pH, O₂, temperaturës, turbullirës dhe klorit – 2 copë

Kjo pajisje lidhet drejtpërdrejt me funksionin final të objektit si sistem furnizimi me ujë të pijshëm. Preventivi përfshin veprën e marrjes, depo uji, linja transmetimi dhe rrjete shpërndarëse; në të parashikohen gjithashtu matësa, pajisje hidromekanike dhe elemente të funksionimit të sistemit. Instrumenti shërben për kontrollin e parametrave bazë të ujit gjatë provave, shpëlarjes, dezinfektimit dhe vënies në funksion të rrjetit. Kërkesa për 2 pajisje lidhet me ekzistencën e dy sistemeve/zonave kryesore të furnizimit, Reps dhe Lgjin, si dhe me mundësinë e kryerjes së kontrolleve në pika të ndryshme.

26. Pajisje gjeodezike GPS – 1 copë

GPS-i gjeodezik është i domosdoshëm për piketimin, përcaktimin e koordinatave, kontrollin e aksit të tubacionit, kuotave dhe pozicionit të objekteve të rrjetit.

Kjo kërkesë argumentohet veçanërisht nga shtrirja prej rreth 13.1 km e linjave dhe rrjeteve dhe nga numri i madh i pushtave, nyjeve dhe objekteve hidroteknike përgjatë traseve.

Një pajisje GPS është e mjaftueshme dhe proporcionale për ekipin topografik të objektit.

27. Kontenier ndërtimi stacionar – zyrë – 1 copë

Kërkesa për 1 kontenier zyre lidhet me nevojën për organizimin teknik dhe administrativ të kantierit gjatë realizimit të një kontrate me shtrirje dhe kompleksitet të konsiderueshëm.

Ai shërben për qëndrimin e drejtuesit teknik dhe stafit të kantierit, ruajtjen e projektit, vizatimeve, librit të masave, dokumentacionit të sigurisë, procesverbaleve, dokumentacionit të materialeve dhe koordinimin e përditshëm të punimeve.

Duke qenë se kontrata përfshin vepër marrjeje, dy linja dërgimi, dy rrjete shpërndarëse dhe depo uji, ekzistenca e 1 zyre kantieri është një kërkesë minimale për administrimin teknik të punimeve.

Argumentimi i sasive të kërkuara

Sasitë e mjeteve nuk janë përcaktuar vetëm në funksion të ekzistencës së një zëri të veçantë të preventivit, por edhe në funksion të volumeve kumulative dhe nevojës për zhvillimin paralel të proceseve të punës.

Veçanërisht: 2 eskavatorë, për shkak të kilometrave të traseve dhe volumeve të larta të gërmimit; kamionët e kategorive të ndryshme, për të siguruar transportin si në distanca të mëdha, ashtu edhe në zona me akses të kufizuar; 2 autobetoniera, 2 autopompa dhe 2 vibratorë, për të garantuar vazhdimësinë e proceseve të betonimit; 2 gjeneratorë dhe 2 saldatrice, për zhvillimin paralel të punimeve në fronte të ndryshme; ndërsa për pajisjet me funksion më të specializuar, si autovinci, grejderi, asfaltoshtuesja, autobitumatricja, GPS-i, fadroma dhe autoboti, është kërkuar vetëm 1 copë, duke respektuar proporcionalitetin.

Kërkesa për minimumi 40 komplete kokore dhe jelekë fosforeshentë lidhet drejtpërdrejt me numrin e punonjësve që do të angazhohen në kantier dhe me natyrën e punimeve që zhvillohen në terren. Objekti përfshin punime gërmimi, hapje kanalesh, montim tubacionesh, punime betoni dhe betonarmeje, transport materialesh, përdorim makinerish të rënda dhe ndërhyrje në zona rrugore.

Në këto kushte, punonjësit janë të ekspozuar ndaj rrezikut nga rënia e materialeve, lëvizja e mjeteve dhe makinerive, si dhe nevoja për t'u identifikuar vizualisht në kantier.

Kokorja mbrojtëse është e nevojshme për mbrojtjen e kokës ndaj goditjeve dhe rënies së objekteve, ndërsa jeleku fosforeshent siguron dukshmëri të lartë të punonjësve, veçanërisht pranë mjeteve të transportit dhe makinerive të ndërtimit.

Numri 40 copë lidhet me nevojën që pajisja personale mbrojtëse të jetë e disponueshme për personelin që punon njëkohësisht në kantier dhe në fronte të ndryshme pune. Duke qenë se objekti ka shtrirje të konsiderueshme dhe mund të zhvillohen disa procese paralelisht, ky numër është i arsyeshëm për garantimin e mbrojtjes individuale të stafit.

2. Fikëse zjarri të lëvizshme – minimumi 5 copë

Kërkesa për minimumi 5 fikëse zjarri të lëvizshme lidhet me praninë në kantier të proceseve dhe pajisjeve që mund të krijojnë burime ndezjeje ose rrezik zjarri.

Preventivi përmban punime dhe pajisje elektrike, saldim, përdorim gjeneratorësh, pajisje mekanike, karburante për makineritë dhe materiale të tjera që kërkojnë masa parandaluese ndaj zjarrit.

Fikëset duhet të pozicionohen në pika të ndryshme të kantierit, veçanërisht: pranë gjeneratorëve dhe pajisjeve elektrike; pranë zonave ku kryhen punime saldimi; pranë zyrës/kontenierit të kantierit; në zonat e magazinimit të materialeve; në frontet ku përdoren makineri dhe mjete me karburant.

Numri prej 5 copësh lejon shpërndarjen e tyre në disa pika kryesore të kantierit dhe siguron reagim të menjëhershëm në rast incidenti.

3. Prozhektorë për ndriçim nate – minimumi 4 copë

Kërkesa për minimumi 4 prozhektorë ndriçimi lidhet me nevojën për garantimin e kushteve të sigurta të punës në raste të ndriçimit të pamjaftueshëm, gjatë orëve të mbrëmjes ose në zona ku ndriçimi publik mungon.

Objekti ka një shtrirje të gjerë territoriale dhe përfshin linja dërgimi dhe rrjete shpërndarëse të shtrira në disa kilometra. Në këto kushte, disa fronte pune mund të jenë larg burimeve të ndriçimit publik.

Prozhektorët janë të nevojshëm për: ndriçimin e kanaleve dhe zonave të gërmimit; ndriçimin e zonave të montimit të tubacioneve; sigurimin e dukshmërisë për operatorët e makinerive; ndriçimin e pikave të rrezikshme dhe zonave të kalimit.

Numri prej 4 prozhektorësh mundëson ndriçimin e më shumë se një fronti pune ose të pikave kryesore të kantierit në të njëjtën kohë.

4. Komplet i ndihmës së shpejtë – minimumi 5 copë

Kërkesa për minimumi 5 komplete të ndihmës së shpejtë lidhet me karakterin e punimeve të ndërtimit dhe me nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në rast lëndimi.

Punimet përfshijnë përdorimin e makinerive të rënda, veglave mekanike dhe elektrike, gërmime, punime betoni, armature, saldim dhe transport materiale, të gjitha procese që mund të shoqërohen me rrezik dëmtimi fizik.

Për shkak të shtrirjes së objektit në disa kilometra dhe zhvillimit të punimeve në fronte të ndryshme, nuk do të ishte efektive që i gjithë kantieri të mbështetej vetëm në një komplet të vetëm.

Kërkesa për 5 komplete mundëson vendosjen e tyre pranë pikave kryesore të punës, pranë zyrës së kantierit dhe pranë fronteve më të largëta, duke garantuar akses të shpejtë në rast incidenti.

5. Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – minimumi 7 copë

Kërkesa për minimumi 7 tabela paralajmëruese lidhet drejtpërdrejt me karakterin linear dhe të shpërndarë të kantierit.

Punimet përfshijnë hapje kanalesh, gjurmime, lëvizje kamionësh dhe makinerish, punime në ose pranë rrugëve, si dhe zona ku mund të ketë akses të personave të tretë.

Tabela paralajmëruese janë të nevojshme për të sinjalizuar:zona me gjurmime të hapura;kalim dhe punë të makinerive të rënda;zona me rrezik elektrik;zona ku kryhen saldime;hyrje-daljet e kantierit;segmente me kufizim kalimi;përdorimin e detyrueshëm të pajisjeve mbrojtëse personale. Numri prej 7 tabelash është i lidhur me nevojën për sinjalizimin e disa pikave të rrezikut njëkohësisht dhe me shtrirjen e madhe të objektit, duke mundësuar që kantieri të jetë i identifikueshëm dhe i siguruar në mënyrë të vazhdueshme.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 9 (nente) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

2.3.7 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit